



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura IV**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Integrime Evropiane  
Mbledhja nr. 40  
Prishtinë, më 30.01.2012, në orën 13:00.  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Blerta Deliu – Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Blerim Shala, Suzana Novobërdali dhe Albert Kinolli.

**Munguan:** Sasha Milosavljeviq dhe Fatmir Limaj.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Adelina Demolli.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Venera Mjekiqi- Kuvend; Lejla Selimi-OSBE; Besim Zeqiri-ICO.

*Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.*

**R E N D I I D I T Ë S**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 3. Raportim i ministres, Vlora Çitaku për Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian për vitin 2012;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 5. Shqyrtimi i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2012;**
- 7. Të ndryshme.**

**Kryetari** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua me ndryshimet si në vijim.*

### **3. Raportim i ministres, Vlora Çitaku për Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian për vitin 2012**

**Kryetari** –Tha se Komisioni ka paraqitur raportin periodik të Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës ku është miratuar në seancë plenare dhe po ashtu është miratuar edhe Plani i Veprimit për këtë vit. Ai shtoi se jemi në fazën e zbërthimit të detyrave dhe tendenca jonë është të rritet monitorimi i zbatimit të ligjeve sipas rekomandimit të Komisionit Evropian, pra rritjen e mbikëqyrjes. Ftoi ministren që të paraqesë Planin e Veprimit të Partneritetit Evropian.

**Vlora Çitaku- Ministre e Ministrisë së Integrimeve Evropiane-** PVPE-ja është hartuar nga stafi i Ministrisë së Integrimeve Evropiane në bashkëpunim me të gjitha institucionet e Kosovës. Meqenëse integrimi evropian mbetet prioriteti kryesor i Qeverisë së Kosovës, Plani i Veprimit i Partneritetit Evropian është dokumenti kryesor afatmesëm planifikues, i cili ka për qëllim adresimin e sfidave dhe prioritetëve kyçe afatshkurtra dhe afatmesme të identifikuar nga Partneriteti Evropian. Procesi i hartimit të PVPE-së ka filluar në nëntor të vitit 2011 dhe është finalizuar për më pak se tre muaj. Plani në fjalë është në pajtim të plotë me kriteret e Kopenhagës dhe Madridit dhe përmban tre kapituj kryesorë: kriteret politike, kriteret ekonomike dhe standardet evropiane. Duke pasur parasysh rëndësinë prioritare të PVPE-së, si një dokument kryesor mbarëqeveritar për integrim evropian, rishikimi i këtij plani ka marrë parasysh prioritetet e Qeverisë dhe programin e saj, draftbuxhetin 2012, kornizën afatmesme të shpenzimeve, strategjitë e ndryshme sektoriale dhe planet e tyre të veprimit, rekomandimet dhe sfidat e dala nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian si dhe ato nga DPSA. PVPE-ja 2012 ka gjithsej 261 veprime, prej tyre 62 veprime janë paraparë në fushën e kriterëve politike, 32 veprime në fushën e kriterëve ekonomike dhe 167 për standardet evropiane. Me qëllim që PVPE-ja të jetë një dokument më i matshëm dhe më praktik, këtë vit janë përcaktuar edhe indikatorët matës në nivel të veprimeve. Vlen të theksohet se është shënuar progres në përlllogaritjen e kostos së PVPE-së 2012 dhe lidhjen e tij me buxhetin. Kostoja e totale e PVPE-së 2012 është vlerësuar të jetë rreth 826,557,499 €, ku 764,559,173 € planifikohet të mbulohen nga Buxheti i Kosovës, 54,156,416 € planifikohet të mbulohen nga donatorët, ndërsa 7,841,909 € është vlerësuar të jetë mungesa.

**Kryetari**, pyeti: çka prisni të përfshijë Udhërrëfyesi për procesin e liberalizimit të vizave dhe sa po arrihet të koordinohet puna në procesin e riatdhesimit, pasi që armiku kryesor i procesit të liberalizimit të vizave mbetet migrimi ilegal?

**Vlora Çitaku-** Ka ekzistuar një rrezik real që për shkak të përvojave gjatë procesit të liberalizimit të vizave me vendet e rajonit, Kosovës t'i imponohet një proces i

ndërmjetëm mes atij të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve fqinjë, por procesi i liberalizimit të vizave për Kosovën do të jetë i njëjtë si për vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe strategjia do të quhet udhërrëfyes. Sfidë më e madhe është luftimi i migrimit ilegal. Nga përvojat e vendeve të rajonit kemi kuptuar se numri më i madh i azilkërkuesve kanë qenë ata të komuniteteve joshumicë dhe nga ne është kërkuar që të ofrojmë dhe përgatisim plane konkrete për akomodimin e komunitetit joshumicë. Udhërrëfyesi brenda pak muajsh do t'i dorëzohet Kosovës. Falënderoi kryetarët e komunave për punën e shkëlqyer sa i përket procesit të riatdhesimit.

**Alma Lama-** Tha se duke u bazuar në Raportin e Progresit theksi është vënë tek disa çështje, por një më e veçanta që edhe këtë vit ka marrë hapësirë është çështja e problemeve në veri të Kosovës ku Qeveria është kritikuar për situatën atje edhe pse nuk është tërësisht përgjegjëse. Ka marrë kritika, sepse nuk ka ofruar ndonjë zgjidhje ose plan të veprimit. Andaj, pyeti: Në lidhje me këtë çështje, çka ka planifikuar Qeveria e Kosovës, në mënyrë që të përmirësohet gjendja atje, a ka ndonjë plan konkret?

**Vlora Çitaku-** Gjendja në veri është si produkt i një gjendje të tillë tash e dymbëdhjetë vite. Për herë të parë, më 25 korrik të vitit të kaluar kemi pasur një veprim konkret të ndërmarrë nga Qeveria, veprim ky i cili ka marrë mbështetjen e tërë spektrit të gjerë politik për rivendosjen e rendit dhe të ligjit në atë pjesë të vendit. Ajo shtoi se, Komisioni Evropian ka kërkuar nga institucionet e vendit që të kenë një strategji gjithëpërfshirëse për normalizimin e gjendjes në veriun e Kosovës. Strategjia e vetme që ne do të operacionalizojmë është Plani i Ahtisaarit, andaj shumë shpejt do të prezantojmë një plan veprimi, duke u bazuar në substancën e Pakos së Presidentit Ahtisaari.

**Alma Lama-** Tha se, kjo është shumë e përgjithshme. Po flasim për Planin e Veprimit për vitin 2012 dhe për hapat konkretë që do t'i ndërmarrë Qeveria për të arritur atë. Çfarë hapash konkretë do të ndërmarrë Qeveria?

Sipas saj, aty ka nevojë për dy gjëra: e para çështja e lirisë së lëvizjes dhe e dyta çështja e ekonomisë. Andaj në këto dy paradigma, çfarë plani ka zhvilluar Qeveria e Kosovës për vitin 2012? Nuk po flasim për Planin e Ahtisaarit, ose si konkretisht do të realizohet kjo.

**Vlora Çitaku-** Tha se jam këtu për të prezantuar PVPE-në e jo Planin e Qeverisë për pjesën veriore. Ajo çka mund të konfirmoj në emër të Qeverisë së Kosovës është se Kosova ka vetëm një plan, një platformë e ajo është implementimi i Pakos së Presidentit Ahtisaari në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

**Blerim Shala-** Si çështje e parë tha se është ndërrimi i mendimit për Kosovën në BE ku ne nuk kemi strategji të liberalizimit të vizave, por kemi Udhërrëfyes për liberalizimin e vizave. Dihet se rëndom, prej momentit kur një shtet pretendent për marrjen e liberalizimit të vizave merr udhërrëfyesin zakonisht kalohen së paku dy vite të plota deri në marrjen e liberalizimit të vizave. Andaj, pyeti se a do të jetë ky rast edhe me Kosovën. Çështja e dytë që lidhet me kërcënimin më të madh për të mos marrë liberalizimin e vizave është çështja e migrimit ilegal i cili në rastin e Kosovës do të kishte motive ekonomike, pasi tani motivet politike nuk ekzistojnë. Pyeti a ekziston vetëdija në Qeverinë e Kosovës se çështja e emigrimit ilegal lidhet me stabilitetin brenda vendit,

sepse sa më stabile të jetë Kosova në segmentin ekonomik dhe social, aq më pak do të ketë emigrues ilegalë. Është shumë e qartë se do të mund të humbim liberalizimin e vizave, sepse dihet fare mirë që do të ketë mundësi të rivendosjes së një regjimi të vizave. Dihet që kriteret në kuadër të Udhërrëfyesit kanë të bëjnë edhe me sundimin e ligjit, kontrollin e kufirit dhe dashtë e pa dashtë vjen edhe veriu. Veriu duhet të kontrollohet si territori, ashtu edhe pikat kufitare. Ju kisha lutur për sqarim.

**Vlora Çitaku-** Për fat të mirë Qeveria dhe institucionet e Kosovës kanë punuar një kohë të gjatë njëanshëm në përmbushjen e kriterëve që derivojnë për liberalizimin e vizave. Para dy viteve Qeveria ka miratuar Udhërrëfyesin i cili është adaptuar nga udhërrëfyesit e vendeve të rajonit. Shumë kriterë të cilat vendet e rajonit i kanë përmbushur në një fazë shumë të avancuar të procesit të liberalizimit të vizave, ne i kemi të përmbushura qysh tani ende pa filluar procesi i liberalizimit. Shtoi se, nëse ne e mbajmë këtë tempo të punës, do të jemi në gjendje që më shpejt se vendet e rajonit të përfundojmë këtë proces. Sa i përket datës se kur do të bëhet liberalizimi i vizave, tha se nuk mund të japë datë të saktë në rast se nuk do të isha në gjendje ta mbajë atë, sepse nuk varet ekskluzivisht nga ne. Për liberalizimin e vizave armiku më i madh është emigrimi ilegal. Ka kaluar koha e migrimeve tani zgjidhjen e problemeve ekonomike duhet ta kërkojnë në Kosovë. Kemi nënshkruar marrëveshje të riatdhësit me shumë shtete të BE-së dhe koha e azilit për shtetasit e Kosovës ka kaluar. Qeveria e Kosovës po punon për përmirësimin e gjendjes ekonomike në vend. Për këtë arsye vitin e kaluar kemi miratuar vizionin ekonomik për Kosovën dhe IPA-në e vitit 2013 do të jetë kryesisht e orientuar në përmbushjen e objektivave ekonomike. E dimë se Kosova ka shumë probleme kronike, ndonëse raportet e fundit të Bankës Botërore e vendosin Kosovën në një vend shumë kredibil dhe parametrat ekonomikë janë më pozitiv sesa të vendeve tjera të rajonit, por ka ende shumë punë për t'u bërë. Kontrollimi i menaxhuar i kufirit është një ndër kriteret që duhet përmbushur për liberalizimin e vizave, vendimi i marrë më 25 korrik ka ndikuar drejtpërdrejt në fuqizimin e kontrollimit të kufirit dhe asaj pjese të territorit të Republikës së Kosovës. Integriteti territorial i Kosovës është vulosur atë ditë. Ne tani duhet të punojmë më shumë në shtrirjen e sovranitetit të institucioneve të Republikës së Kosovës edhe në pjesën veriore.

**Blerta Deliu-Kodra,** pyeti: Sa do të ketë lehtësira për qytetarët për t'u pajisur me viza tani që ka filluar procesi i liberalizimit të vizave?

**Vlora Çitaku-** Njoftoi se ka qenë praktikë që para aktit të liberalizimit, si fazë e ndërmjetme ka qenë ajo e fasilitimit. Paralelisht me procesin e liberal është bërë lehtësimi i procedurave për pajisjen e qytetarëve të një vendi me viza. Shumë vende të BE-së tashmë kanë filluar njëanshëm në lehtësimin e procedurave për dhënien e vizave dhe japin viza më afatgjate për shtetasit e Kosovës. Shtoi se ne kemi qenë shumë të vëmendshëm që në fazat e mëhershme mos të kërkojmë fasilitim, por kemi kërkuar që të kalojmë në proces të dialogimit për liberalizimin e vizave, sepse kemi pasur drojë që një ofertë e tillë do t'i mjaftonte ndokujt në kuadër të BE-së për të thënë që Kosovës tashmë i kemi ofruar diçka. Për ne ka qenë shumë e rëndësishme që të hyjmë në dialog për liberalizimin e vizave. Jemi përqendruar që procesi të jetë i ngjashëm me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor .

**Vjosa Osmani** – Tha se përkrah çështjes së emigrimit ilegal që është përmendur nga eurodeputetja, po ashtu çështja e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit janë dhe mbetin disa prej sfidave kryesore. Shtoi se sa kam parë prej Planit të Veprimit, shumica e veprimeve që janë planifikuar të ndërmerren janë të ngjashme apo edhe identike me ato të vitit të kaluar. Ne e kemi parë që një qasje apo plan i tillë nuk është treguar të jetë i suksesshëm. Pyeti, nëse ka plan konkret për implementimin e këtyre ligjeve, sepse shumica e ligjeve janë miratuar në Kuvendin e Kosovës që kanë të bëjnë me këtë fushë dhe po shihet qartë se në praktikë miratimi i disa letrave nuk po kryen punë. Një ndër sfidat kryesore që e kemi pasur vitin e kaluar, sidomos në ligjet e kësaj fushe, ka qenë mungesa e buxhetit për implementimin e tyre, gjithnjë si shembull është përmendur Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve. A ka plane të tjera konkrete që Ministria e Integritetit Evropian e ka paraparë që të arrihet sukses në këtë fushë, duke pasqyruar se këto pika që janë përmendur si të vitit të kaluar nuk po tregojnë të kenë sukses në praktikë. Çështja e Planit ekonomik për Veriun që është përmendur në Raportin e Progresit, ne e kemi dëgjuar si deklaram. Disa herë na është thënë nga ana e zyrtarëve të Komisionit Evropian se pritet nga Qeveria të ndërtojë një plan konkret ekonomik. Pyetja ime është nëse ju në kontakt me ta keni kërkuar nga ana e Komisionit Evropian që fonde të caktuara të Komisionit Evropian të jepen për arritjen e implementimit të një strategjie të tillë, sepse kjo nuk është përjashtuar si ide nga ana e Komisionit Evropian. Dihet që zyrtarë të lartë të Qeverisë kanë deklaruar disa herë që problemi kryesor i zbatimit të masave ekonomike ka qenë se nuk e dinë se me kë të punojnë, meqë ka struktura ilegale në atë pjesë dhe ky vazhdon të jetë problem. A keni konsideruar që investime të Komisionit Evropian të konsiderohen për çështjen e veriut?

**Vlora Çitaku**- Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është një ndër sfidat më të mëdha që kanë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe është një sfidë me dimension rajonal dhe nuk mund të luftohet nga Kosova si etnitet i izoluar. Për këtë arsye është e rëndësishme përfshirja e Kosovës në iniciativat rajonale të cilat kanë për qëllim luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Sa i përket luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit ne kemi strukturën ligjore më të avancuar. Nuk është në kompetencë të Ministrisë së Integritetit Evropian që të hartojë strategji apo plan për luftimin e këtyre dukurive, por ajo që ne mund të bëjmë si Ministri është që të kërkojmë nga mekanizmat përgjegjës që të bëjnë përmbushjen e detyrimeve që dalin nga Pakoja Integruese e Kosovës. Qeveria e Republikës së Kosovës para pak ditësh ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Luftë Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit për vitin 2012-2016, ku janë paraparë hapat konkretë që duhet të ndërmarrin institucionet e Kosovës për përmbushjen dhe realizimin e kësaj Strategjie. Paralelisht me këtë, Presidentja e Kosovës ka paraparë themelimin e një këshilli kombëtar për luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Qeveria e Republikës së Kosovës ka vetëm një plan, e ai është implementimi i tërësishëm i dispozitave të Presidentit Ahtisaari, çdo hap tjetër do të cenonte funksionalitetin e institucioneve të Republikës së Kosovës. Ajo pjesë e territorit të Kosovës tash e 12 vite është tërësisht e izoluar nga realiteti kosovar dhe në atë pjesë fare pak kanë arritur investimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në tre katër vitet e fundit ka pasur investime kapitale, ato nuk kanë mundur të implementohen në mënyrë të kënaqshme për shkak të pengesave që kemi hasur atje. Për ne ka qenë e rëndësishme që

të evitojmë një skenar të cilin e kanë synuar fqinjët veriorë për krijimin e një fondi të veçantë nga mbledhja e taksave doganore nga pika 1 dhe 31. Këtë gjë nuk e kemi lejuar dhe nuk do ta lejojmë, sepse është kundër dispozitave të dokumentit të Ahtisaarit. Të gjitha taksat që mblidhen në këto dy pika derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës. Ajo pjesë e Kosovës ka nevojë për investime dhe Komisioni Evropian investon tash atje dhe ka shumë projekte të cilat po realizohen atje edhe nga donatorët e tjerë. Jemi duke shikuar mundësit për krijimin e një agjende gjithëpërfshirëse në të cilën do të përfshiheshin investimet ekonomike dhe hapat tjerë paralelë që duhet të ndërmerren. Realisht pa funksionim të institucioneve nuk mund të ketë as zhvillim të mirëfilltë ekonomik pavarësisht shumës së investimeve.

**Vjosa Osmani-** Tha se arsyeja pse e bëra këtë pyetjen e dytë ishte, sepse ne kemi parë të gjithë shembullin e Irlandës Veriore dhe projektet e pages të cilat ata i fitojnë çdo vit të cilat mund të hynë edhe brenda projekteve të IPA-së, kështu që në këtë kontest ishte edhe pyetja ime. Nëse planifikohet diçka e tillë kryesisht duke planifikuar projekte investuese në veri të Kosovës që është duke u konsideruar nga ana e juaj. Është dëshmuar që deri më tani projektet e Komisionit Evropian dhe USAID-it kanë qenë njëetnike dhe duhet që insistimi i Qeverisë të jetë që këto të jenë shumetnike dhe vërtet çdo projekt të kenë efekte integrale.

**Xhavit Haliti-** Është bërë përpjekje maksimale, aspirata e Kosovës është për të qenë pjesë e BE-së. Edhe Ministria edhe ministrja është lavdëruar nga ndërkombëtarët, por edhe nga vendorët që kanë punuar shumë dhe kanë bërë përpjekje maksimale. Ne kemi një numër enorm për t'u arratisur nga Kosova, ne themi që kemi kontrollin e kufirit, por realisht ne nuk kemi kontroll në asnjë kufi dhe se kalimi ilegal bëhet pothuajse pa problem në të gjithë kufijtë e Kosovës. Nuk ka roje kufitare çfarë ka pasur dikur, por tani këtë e bën policia dhe është më e lehtë për t'u kaluar. Unë nuk e shoh të realizueshme shpejt ndaljen e përpjekjeve për të ikur nga Kosova dhe për të gjetur punë diku jashtë, duke e pasur parasysh numrin e madh të papunëve. E shoh të domosdoshme që të bëhet një përpjekje maksimale që të fillojë lehtësimi për vizat, veçanërisht për vizat biznesore. Nuk e shoh të arsyeshme që të mos bëhen përpjekje për t'u prodhuar pasaporta pune për njerëzit e biznesit që kanë për të lëvizur në drejtim të shteteve të ndryshme të Evropës për veprimet për të cilat ka nevojë biznesi i Kosovës. Ashtu siç e shoh që nuk është i pamundur negociimi për pasaporta diplomatike që të mos ketë nevojë të marrin viza, sepse është interes i Kosovës që të kemi mundësi udhëtimit të lirë. Sa i përket liberalizimit, tha se edhe unë jam skeptik se mund të bëhet shpejt, sepse janë pengesat të cilat po i sjellim vetë dhe nuk e besoj që është dëshirë e qytetarëve që të ballafaqohen me këtë problem. Sa i përket trajtimit të të kthyerve nga jashtë, tha se një pjesë e tyre janë familjarë të cilët kanë jetuar nëpër kampe me ndihma sociale, por janë edhe një kategori me kartela kriminale dhe janë kategoria e cila e rrezikon edhe sigurinë në Kosovë. Pyeti: Si administrohet procesi i kthimit të kësaj kategorie në hyrje të Kosovës, a bëhet marrja e shenjave të gishtërinjve, a i bëhet testi nëse ka ndonjë sëmundje të transmetueshme, a është përdorues droge, a ka statistika ministria sa të burgosur kanë kaluar nëpër kufij dhe sa janë në pritje për t'u kthyer në Kosovë?

**Vlora Çitaku-**Tha se çështja e kontrollit të kufirit është çështje ndërshtetërore dhe kontrollohet edhe nga shteti tjetër. Të dhënat të cilat ne i kemi pranuar nga disa vende të cilat kanë fluksin më të madh të azilkërkuesve flasin se 80% të azilkërkuesve nga Kosova shkojnë në këto shtete përmes rrugëve tokësore. Po ashtu na është konfirmuar nga këto shtete se numri më i madh i tyre shkojnë kolektivisht, që do të thotë se bëhet fjalë për rrjete të organizuara kriminale që bëjnë trafikimin e qenieve njerëzore nga Kosova me qëllim të përfitimit. Pas marrjes së këtyre informatave ne kemi ndërmarrë hapa konkretë në luftimin e këtyre rrjeteve që janë rrjete rajonale. Sa i përket statistikave për riatdhesimin e personave me kartela kriminale në bazë të marrëveshjeve që kemi bërë me këto shtete, specifikohen qartë hapat dhe procedurat të cilat ndiqen në momentin kur një person me dosje kriminale riatdhesohet në Kosovë. Ka vende që nuk e bëjnë riatdhesimin e personave me dosje kriminale pa vuajtjen e dënimit. Ka vende të cilat bëjnë depërtimin e personave me dosje kriminale edhe pa kaluar procedurat e caktuara. Ne paraprkishtë njoftohemi me listën e personave të cilët do të riatdhesohen, njoftohemi me cv-të e tyre, a janë familjarë, individual apo persona me dosje. Personat të cilët kanë dosje trajtohen menjëherë nga institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës. Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur një strategji të veçantë për trajtimin psikologjik për personat e riatdhesuar.

**Blerta Deliu- Kodra-** Tha se kemi paralajmërim se në muajin shkurt do të themelohet Këshilli Kombëtar për Integritet Evropian. Cili do të jetë roli i këtij Këshilli për ta çuar përpara agjendën evropiane të Kosovës?

**Vlora Çitaku-** Njoftoi se mbledhja konstituive e këtij Këshilli do të shtyhet për disa ditë për shkak se komisionari Fyle ka shprehur dëshirën që të marrë pjesë në takimin konstituiv të Këshillit. Nuk është assesi në domenin e Këshillit Kombëtar të bëjë zëvendësimin e asnjë institucioni tjetër. Ne e dimë që konsensusi politik arrihet në Kuvend, por konsensusi shoqëror shkon përtej konsensusit politik dhe ne synojmë që në Këshillin Kombëtar t'i kemi të përfaqësuar jo vetëm subjektet politike, por sidomos shoqërinë civile, botën akademike e të biznesit. Këshilli do të takohet disa herë në vit dhe do të bëjë harmonizimin e qëndrimeve strategjike në mes aktorëve të ndryshëm.

**Alma Lama-** Sa i përket Këshillit Kombëtar, tha se sigurisht ai nuk mund të zëvendësojë institucionet, por ne kemi konsensus si shoqëri për sa i përket integriteteve, por nuk kemi integritet ose nuk po ndërmarrim hapa për të bërë integritet, sepse integritetet në fund të fundit janë plotësim standardesh evropiane dhe pa i plotësuar ato standarde nuk shkojmë dot aty. Në Raportin e Progresit ka pasur vërejtje të mëdha për sa i përket administratës publike dhe kërkesën për reformë të administratës e cila është e stërngarkuar e politike. Çfarë masash do të ndërmerren gjatë këtij viti për reformimin dhe depolitizimin e saj?

**Vlora Çitaku-** Procesi i integritetit evropian është një pako reformash, një udhërrëfyes për një reformim të tërësishëm të jetës institucionale dhe publike në Kosovë, mirëpo nuk është tavolinë suedeze. Nuk mund t'i marrim ato pjesë të cilat neve na pëlqejnë si vlera evropiane dhe të mos i marrim të tjerat. Listën e detyrave nuk e përcaktojmë ne, ka shumë mekanizma në Bruksel të cilët bëjnë përgatitjen e vendit potencialisht anëtare të cilat duhet të bëjnë përmbushjen e atyre detyrave. Administrata publike është shtylla

kurrizore e një shteti. Kosova ka nevojë për një reformë të thellë të administratës publike, për profesionalizimin e administratës publike dhe mënyra e vetme për depolitizim të administratës është fuqizimi i profesionalizimit. Kemi mekanizmat ligjorë dhe tashmë duhet vetëm të bëjmë implementimin e tyre dhe se reforma e administratës publike është top prioritet për Qeverinë dhe institucionet e Kosovës. Ka një varg veprimesh të cilat janë paraparë të ndërmerren kryesisht nga Ministria e Administratës Publike.

**Alma Lama-** Dua konkretisht të di, do të ketë largime nga puna, do ketë zëvendësime, çfarë hapa do të merren konkretisht?

**Vlora Çitaku-** Qeveria nuk mund të bëjë largime nga puna duke u thirrur në përcaktim subjektiv të kujt do qoftë se a është profesional apo i politizuar dikush a jo. Në mbledhjen e Komitetit punues për Integrim Evropian kam kërkuar nga të gjithë sekretarët që në vlerësimin periodik të punës që iu bëhet punëtorëve, ai vlerësim të jetë real dhe ai vlerësim mund të shërbejë si bazë për zëvendësimin e punëtorëve. Por përderisa ka raporte pozitive për vartësit e tyre zëvendësimet nuk mund të bëhen.

**Albert Kinolli-** Tha kur flasim për procesin e liberalizimit të vizave është e pashmangshme të mos flasim edhe për procesin e riatdhesimit. Tha se personalisht jam shumë i kënaqur me këtë proces. Pyeti: Sa jeni ju të kënaqur me procesin e riatdhesimit nëpër komuna për vitin 2011?

**Vlora Çitaku-** Tha se jam jashtëzakonisht e kënaqur me punën e të gjithë kryetarëve të të gjitha komunave në përmbushjen e kritereve që derivojnë nga Strategjia për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar. Ndërsa sa i përket këtij viti, tha se jam e bindur se ky proces do të jetë shumë më i mirë për faktin se vitin e kaluar kemi bërë decentralizimin e fondeve për personat e riatdhesuar, është ndërtuar infrastruktura ligjore dhe kështu ky vit do të jetë edhe më i mbarë se viti i kaluar.

**Kryetari-** Raportimi i juaj i radhës parashihet që të jetë në muajin mars kur edhe planifikohet të hartohet raporti i ardhshëm për Planin e Veprimit. Falënderoi për bashkëpunim.

#### **4. Shqyrtimi i Projektligjin 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

**Kryesuesi -** E ftoi deputeten Alma Lama, referuese e Projektligjit, ta paraqesë raportin për këtë Projektligj.

**Alma Lama –** Pas vërejtjeve të dhëna nga Komisioni Evropian, Komisioni funksional ka marrë në shqyrtim edhe një herë këtë Projektligj dhe ka inkorporuar vërejtjet e dhëna nga Komisioni Evropian. I vetmi amendament i cili nuk është inkorporuar është ai që i përket përqindjes së buxhetit për të. Komisioni Evropian ka kërkuar që buxheti vjetor për RTK- në të jetë 0.7% , ndërsa Komisioni funksional ka kërkuar që ky buxhet të jetë 0.9%. Andaj, kërkoj që për këtë



çështje të diskutohet në mbledhjen e radhës pasi të diskutohet me kryetarin e Komisionit Funksional.

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë*

#### **Përfundim**

**Projektligji 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë, me amendamentet e Komisionit Funksional, do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.**

**5. Shqyrtimi i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së**

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë*

#### **Përfundim**

**Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së do të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së Komisionit.**

**6. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komisionit për vitin 2012**

*Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë*

#### **Përfundim**

***Miratohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2012.***

Mbledhja përfundoi në orën 14:40.

**E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit**

-----  
**Lutfi Haziri**